

DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE



GREQIA PUBLIKON STATISTIKAT E INVESTITORËVE TË HUAJ, DOMINOJNË INVESTIMET SHQIPTARE

Ministria e Jashtme dhe Administrata e Decentralizimit në Greqi publikojnë statistikat e investitorëve emigrantë dhe tabela përbën padyshim një surprizë të mirë për shqiptarët. Dinamika e komunitetit shqiptar në Greqi në rritje të vazhdueshme vitet e fundit përbën një fakt të padiskutueshëm. Statistikat e fundit janë ndër faktorët më tregues. Kështu, në kategorinë e lejeve të qëndrimit 5-vjeçare, të ashtuquajturat Golden Visa, me investim në pasuri të patundshme 250.000 euro për vitin 2019 shtetasit shqiptarë renditen pas Kinës. Ndërsa për vitin e pandemisë 2020 renditen të parët.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



A PO RIMËKËMBET EKONOMIA BOTËRORE?

Ekonomitë duken se kanë filluar të rimëkëmben. Analistët po vlerësojnë rritjen e PBB-së globale me 7% ose më shumë në tremujorin e tretë të këtij viti, krahasuar me të dytin. Kjo mund të tingëllojë shpresëdhënëse, por bota duket se është ende shumë larg normalitetit. Qeveritë vazhdojnë të zbatojnë masat e distancës sociale për të mbajtur larg virusin. Këto zvogëlojnë prodhimin. Pasiguria ekonomike si midis konsumatorëve ashtu edhe ndërmarrjeve është afër niveleve rekord dhe kjo me siguri shpjegon hezitimin e kompanive për të investuar. Megjithatë ekonomia globale po funksionon me kapacitet rreth nëntë të dhjetat, ka shumë ndryshime midis industrive në vende të ndryshme. Disa po bëjnë relativisht – dhe çuditërisht – mirë, të tjerët po përjetojnë ditë të errëta.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



SHQIPËRIA DYFISHON EKSPORTET DREJT KINËS

Shqipëria thajse ka dyfishuar eksportin me Kinën në muajin dhjetor. Sipas të dhënave më të fundit të Institutit të Statistikave, në dhjetor 2020, vendi ynë ka eksportuar mallra në vlerë 613 milionë lekë, 266 milionë lekë më shumë se në dhjetor 2019. Nga ana tjetër, edhe importi nga Kina është rritur në muajin përmbyllës së vitit 2020. Sipas Instat, importi i mallrave nga Kina në dhjetor 2020 ka qenë në vlerën 5.3 miliardë lekë, nga 5.2 që rezultojnë për dhjetorin e 2019-ës.

PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI: >>>>



JAVA NË LAJME

GREQI / AMBASADA: GATI DOKUMENTAT PËR APLIKIMET DERI MË 24 DHJETOR 2020



ZVICËR/ ÇFARË DUHET TË DINI PËR TË UDHËTUAR



SI TË APLIKONI ONLINE PËR RINOVIM DOKUMENTASH BIOMETRIKE DHE DEKLARIM TË ADRESËS



KURSI I KËMBIMIT

MONEDHA	BLERJE	SHITJE
USD	101.5	102.5
EUR	123.3	123.9
CHF	114	115
GBP	138.4	139.3
DKK	16 ^{.25}	16.65